



**Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina**

Në mbështetje të nenit 52, paragrafi 52.1 i Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 45, paragrafi 45.2 i Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, dhe të nenit 4, pika 4.3 e Rregullores për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në Komunën e Prishtinës, kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa të Komunës së Prishtinës,

th ë r r e t

mbledhjen e **gjashtë** të Komitetit për Politikë dhe Financa, e cila do të mbahet më **26.09.2018** dhe do të filloj në orën **10:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën nr. 37 (kati II) të Komunës së Prishtinës.

Për mbledhje propozon këtë

REND TË DITËS:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së pestë të Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Propozimvendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2019 dhe Kornizës afatmesme buxhetore për periudhën 2019-2021(KAB);
3. Propozimvendimi për rritje të mjeteve të të hyrave vetanake 2017 dhe për bartje të mjeteve nga viti 2017 në vitin 2018;
4. Të ndryshme.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-060/01-221874/18, më 11.08.2018

KRYESUESI I KOMITETIT
Agim Kuleta



Vërejtje: Lutemi që të merrni pjesë në mbledhje. Në rast pamundësie për të marrë pjesë, lajmërohuni në Shërbimin e Kuvendit, në tel. kontaktues: 038/230-900, lok. 1100.